


Regjistrimi i lindjes garanton:

- IDENTITET përmes fitimit të shtetësisë, emrit dhe mbiemrit
- ARSIMIM falas
- SHERBIM SHENDETESOR falas
- PUNESIM
- LEVIZJE të lirë
- PJESEMARRJE në jetën politike
- STREHIM
- SHERBIME SOCIALE



*Nëse Ju kërkoni informacione të mëtejshme, apo në rast se kërkoni të regjistroni lindjen e fëmijëve me anë të procedurave gjyqësore,  
Ju lutem na kontaktoni në :*

**SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANE**

Rruga "Sami Frashëri", 4 kullat,  
Seksioni III, Apartamenti 1A  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: + 355 4 2253 114  
Tel/Fax: + 355 4 2258 442  
[www.tlas.org.al](http://www.tlas.org.al)

**TE GJITHA SHERBIMET LIGJORE  
JANE FALAS**



Si mund të  
regjistrohet lindja  
e fëmijës

Financuar nga UNICEF

unicef    
1946 - 2006

## Regjistrimi i lindjeve

Regjistrimi i lindjeve është kusht parësor për gëzimin e të drejtave dhe lirive personale, ekonomike, politike, shërbimet shëndetësore, arsimore, etj. Regjistrimi i lindjeve parashikohet në Ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për Gjendjen Civile”.

## Afati i regjistrimit të lindjes së fëmijës

Lindjet e fëmijëve mund të deklarohen dhe regjistrohen në çdo kohë.

Nëse lindja deklarohet brenda **60 ditëve** nga dita e lindjes, për fëmijët e lindur brenda vendit dhe **brenda 90 ditëve**, për fëmijët e lindur jashtë vendit **prindërit mund të përfitojnë një shpërblim në masën 5000 (pesë mijë) lekë nga Shteti.**

## Vendi i lindjes së fëmijës

Lindja e fëmijës në institucionet shëndetësore ose në prani të mjekut, regjistrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në Zyrën përkatëse të Gjendjes Civile.

Lindja e fëmijës jashtë institucioneve shëndetësore dhe pa praninë e mjekut, regjistrohet në Zyrën përkatëse të Gjendjes Civile, pas përfundimit të procedurave gjyqësore.

## Personat që mund të regjistrojnë lindjen e fëmijës

Regjistrimi i lindjes së fëmijës mund të bëhet nga:

- prindërit;
- pjesëtarët madhorë të familjes;
- përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët;
- ose nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen.

## Ku duhet të regjistrohet lindja e fëmijës

Lindja duhet të regjistrohet pranë:

- Zyrës së Gjendjes Civile ku kanë vendbanimin prindërit;
- Zyrës së Gjendjes Civile ku ka ndodhur lindja.



## Detyrimi i institucioneve shëndetësore

Të gjitha institucionet që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që çdo ditë të hënë të dërgojnë në Zyrat e Gjendjes Civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

## Dokumentet që duhet të paraqiten për të regjistruar fëmijën

Çdo person që ka të drejtë për të regjistruar lindjen e fëmijës pranë Zyrës së Gjendjes Civile duhet të paraqesë çertifikatën e asistencës së lindjes, të lëshuar nga institucioni ku ka ndodhur lindja ose vendimin gjyqësor të formës së prerë për vërtetimin e faktit të lindjes.

## A duhet të paguajnë prindërit për regjistrimin e lindjes së fëmijës?

Regjistrimi i fëmijës është pa pagesë.

## Cili do jetë mbiemri që do të marrë fëmija në çastin e regjistrimit?

Nëse prindërit e fëmijës janë të martuar:

- fëmijës i vihet automatikisht mbiemri i përbashkët i prindërve;
- ose i të atit (në rast se prindërit kanë mbajtur pas martesë mbiemrat e tyre).

Nëse prindërit e fëmijës janë të pamartuar:

- fëmijës i vihet mbiemri i nënës;
- kur i ati i fëmijës e njëh fëmijën atëhere fëmijës mund t'i vihet mbiemri i të atit.